



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 15.09.2015

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR DEKRETIN NR. 9206, DATË 14.8.2015, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 80/2015
“PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET
E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik bazuar në kalendarin e punës së tij, në përputhje me kalendarin e punimeve të Kuvendit, në datën 15 shtator 2015 shqyrtoi në cilësinë e komisionit përgjegjës Dekretin nr. 9206, datë 14.8.2015, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e shqipërisë””.

Ky Dekret është dërguar nga Presidenti i Republikës mbështetur në nenet 85 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Komisioni e shqyrtoi këtë projektligj në përputhje me nenin 86 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij Dekreti, në emër të përfaqësuesve të mazhorancës dhe të opozitës në komision, paraqitën qëndrimet e tyre relatorët, znj.Mimoza Hafizi dhe z.Myqerem Tafaj.

Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nga Presidenti i Republikës dhe qëndrimi mazhorancës në komision:

1. Në Dekret është shprehur se ligji ka përqsasje etatiste, duke vendosur në qendër të tij shtetin dhe jo universitetin me studentët dhe trupën pedagogjike.

Vihet re se mungon argumentimi i këtij konkluzioni. Në vend të tij jepen referenca të tilla si Deklarata e Jerevanit apo Procesi i Bolonjës, të cilat shfaqen të palidhura me konkluzionin e arritur.

Mazhoranca nuk është dakord me cilësimin se ligji nr. 80/2015 bart përqsasje etatiste. Vullneti politik i mazhorancës që qeveris sot vendin është respektimi i të gjitha dokumenteve europiane që rregullojnë Hapësirën e Arsimit të Lartë dhe vënia në fokus e universitetit me trupën akademike e studentët.

2. Në Dekret shkruhet se ligji detyron tarifa të larta shkollimi në arsimin e lartë, të papërballueshme për nivelin mesatar të jetës. Si argumente përdoren :

a) *Rrjeshtimi i disa tarifave për studentët si tarifa e aplikimit, tarifa e konkurimit, tarifa e rregjistrimit.*

Sqarojmë se të njejtat tarifa ekzistojnë edhe sot e prej disa vitesh në sistemin e arsimit tonë të lartë. Ky ligj vetëm i ka rimarrë në kuadrin e vet.

b) *Konstatimi se ligji nuk vendos kufizime mbi tarifën në universitetet jopublike.*

Sqarojmë se as sot, por edhe asnjëherë shteti nuk ka ndërhyrë për të vendosur limite mbi tarifën e shkollimit në sistemin jopublik, duke u mbështetur në parimin se këto pagesa rregullohen nga tregu.

- c) ***Konstatimi se ligji nuk përmban rregullime për kufirin e tarifave të shkollimit në universitetet publike dhe as nuk përcakton kritere mbi të cilat do të orientohen IAL dhe shteti për vendosjen e tarifave.***

Kujtojmë se asnjëherë në ligjin e arsimit të lartë nuk është caktuar tarifa e shkollimit. Kjo tarifë vendoset çdo vit nga qeveria, ajo është rrjedhim dhe pjesë përbërëse e politikës së qeverisë dhe mazhorancës qeverisëse për arsimin e lartë. Ndërsa ligjet shkruhen për periudha më të gjata se një mandat qeverisës, ato rregullojnë sistemin, por s'mund të pengojnë qeveritë të aplikojnë politikën e votuar nga njerëzit në zgjedhjet politike, atje ku partitë shpalosin platformat edhe për arsimin e lartë.

Kjo mazhorancë e ka shprehur qartë qëndrimin e saj, të votuar nga populli me votë masive, për mbështetjen e arsimit të lartë me financime në rritje. Ky qëndrim bie në kundërshtim me përfundimet e dhëna në Dekretin e Presidentit. Kjo mazhorancë inkurajon të gjitha politikat që mbështesin arsimimin e shtresave në nevojë. Ky pozicion është politikisht i qartë, dhe nuk lë asnjë shteg për argumentin e pasigurisë juridike, që përmendet disa herë në Dekretin e Presidentit.

Mazhoranca është dakord me rekomandimin se kriteret për vendosjen e tavanit të tarifës së shkollimit duhet të ekzistojnë, të aplikohen e të jenë transparente, por kjo vlen për ato akte ku përcaktohen tarifatat apo tavanit i tyre, siç është rasti i VKM-ve që dalin çdo vit nga qeveria.

- d) ***Përfundimi se ligji synon rritjen e tarifës së studimit, bazuar në një dokument të nxjerrë nga Komisioni për Arsimin e Lartë, nismëtar i ligjit.***

Sqarojmë se ky dokument paraqet vetëm një mendim ekspertësh të fushës, por jo pozicionin e mazhorancës.

- e) ***Lejimi me ligj i kredisë studentore, i cili në Dekret shihet si mekanizëm detyrues, që paraqet rrezik për studentët dhe familjet e tyre.***

Në të kundërtën, mazhoranca e shikon lejimin e kredisë studentore si një mundësi të re për studentët, dhe jo një detyrim për ta.

- f) *Përfundimi se shteti nuk ka marrë asnjë angazhim lidhur me punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve në ciklin e parë.*

Jemi të ndërgjegjshëm se ky problem, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë Hapësirën e Arsimit të Lartë është kryesisht i lidhur me ekonominë dhe tregun. Për më tepër, ne nuk gjejmë ndonjë lidhje mes këtij mendimi dhe tarifave të shkollimit në universitete.

3. Në Dekret shprehet se ligji cënon Kushtetutën, sepse shkel nenin e saj që mbron lirinë akademike dhe autonominë institucionale të IAL.

- a) *Argumenti i parë buron nga ngritja e disa agjencive që do të rregullojnë veprimtarinë në sistemin e arsimit të lartë, meqë këto agjenci do të ushqehen pjesërisht me buxhetin e universiteteve.*

Përkundrazi besojmë se ngritja e këtyre institucioneve do të jetë në dobi të veprimtarisë dhe rritjes së efikasitetit të financimit në arsimin e lartë, pra në opinionin tonë ngritja e këtyre agjencive do të rrisë buxhetin efikas që universitetet përdorin për funksionin dhe zhvillimin e tyre.

- b) *Shprehet kundërshti ndaj faktit se në ligj nuk është përcaktuar përqindja e GDP që duhet t'i shkojë arsimit të lartë.*

Theksojmë se kjo është e pamundur dhe nuk mund të vendoset në asnjë ligj të tillë, i cili ka për detyrë organizimin e sistemit. Kjo përqindje mund të caktohet në ligjin për buxhetin.

- c) *Në Dekret kërkohet që ligji të përcaktojë kriteret për ndarjen e financimeve publike në universitete, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë në ligje të tilla, që rregullojnë sistemin e arsimit të lartë. Shpërndarja e financimit mbetet çështje e politikave të mazhorancës.*

4. Në Dekretin e Presidentit është kërkuar që agjencitë e reja të jenë më mirë të përcaktuara në kuptimin e strukturimit dhe funksionit të tyre.

Mendojmë se ky është një shikim subjektiv, pasi nuk ka ndonjë rregull që të përcaktojë se deri ku mund të shkojë detajimi me ligj i institucioneve të reja që

krijohen. Në Dekret është kundërshtuar edhe baza mbi të cilën ngrihet sigurimi i cilësisë në IAL dhe agjensia përkatëse, por ne theksojmë se ky sistem i ngritur prej vitesh ka profil evropian. Ne besojmë se me ligjin e ri, politika nuk do të pengojë më funksionimin e tij profesional.

5. Në Dekret argumentohet se ligji çënon autonominë universitare dhe lirinë akademike, përmes forcimit të rolit të shtetit në bordin e IAL.

Mendojmë se në argumentin shoqërues ka një konfuzion mes detyrave administruese të bordit dhe funksioneve akademike, që kryhen nga senati i universitetit apo organet e tjera të zgjedhura. Ne besojmë se ndarja në këtë ligj e funksioneve akademike nga ato administrative është një hap i rëndësishëm për mirëmenaxhimin e universitetit.

Në Dekret jepen edhe disa argumente të tjera që e pozicionojnë ligjin në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës. Ne mendojmë se këto argumente kanë marrë përgjigje nga Komisioni i Ligjeve në fazën e shqyrtimit të ligjit në parlament.

Për këto arsye, mazhoranca kërkon rrëzim e Dekretit.

Përfaqësuesit e opozitës mbështetën Dekretin e Presidentit bazuar në argumentat e paraqitura prej Tij në relacionin bashkëlidhur Dekretit dhe votuan pro miratimit të tij.

Në përfundim, komisioni me votat e mazhorancës vendosi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

Relatorë

Mimoza Hafizi

Myqerem Tafaj

ZËVENDËSKRYETAR

Alfred PEZA